



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241589
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05726791

C-IV-14-3367

Ankuesi

R S, Podujevë.

Përfaqësuar nga **Av.B I**, Prishtinë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Driton Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjyqtaren Ganimete Puka, me 23 maj 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN046-0822, datë 14 prill 2014.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit R S në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, t’i paguaj shumën prej 613.18 € dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj shumën prej 61,31 €.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që përfaqësuesit të ankuesit, avokat B I në emër të përpilimit të padisë, të ja paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 104.00 €, gjersa pjesa tjetër e mbetur e kërkuar në shumë prej 208.00 €, refuzohet.
- Shumat** e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 28 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër vendimit nr. PRN046-0822 të datës 14 prill 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej: Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin kërkesa e tij për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë të paspecifikuar nga NSH FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim) ishte refuzuar si e pavlefshme.

Ankuesi pohon se, neni 608 i Ligjit të punës së bashkuar nuk duhet të zbatohet në rastin e pagave të papaguara në procesin e likuidimit për shumë arsye;

Legjislacioni i privatizimit në Kosovë është tepër i komplikuar jo vetëm për punëtor por edhe për ekspertet juridik;

Ligji i punës së bashkuar në Kosovë nuk është Ligj në fuqi në Kosovë dhe atë me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi Ndërmarrjet (RSFJ nr. 77/88 kapitulli IV dhe VI), Gjykata e njeh Ligjin dhe ajo mundet në çdo kohë të verifikoj faktin e lartcekur;

Ligji i AKP-së garanton kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Letra zyrtare e cila ndërpreu marrëdhënien e punës së punëtorëve e lëshuar nga AKM garanton që ndërmarrja do ti përmbush obligimet e saj ndaj punëtorit kur të ketë filluar procesi i Likuidimit. Gjithashtu, mbrojtësi i ankuesit ka pohuar se, ankuesi kishte punuar mbi 5 vite pranë NSH-së në bazë të llogaritjes së dy pagave të fundit të lëshuar nga ndërmarrja, paga bruto e ankuesit ka qenë 306.59 Euro, andaj në bazë të llogaritjes së një page të tij mujore ankuesit i takojnë 613.18 Euro.

Nga të gjitha arsyet propozon që Vendimi i AL të shfuqizohet dhe që gjykata të vendos në pajtim me dispozitat e ligjit të AKP.

Kërkesës për rishikim i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,
- Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 24 mars 2006,
- Letër konfirmimi i datës 17 prill 2024,
- Lista me tri paga të ankuesit nga NSH “Zahir Pajaziti”.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 22 mars 2024 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP pohoi se AL, me rastin e vendosjes, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Tutje, pohon se ankuesi nuk ka parashtruar ndonjë argument se cila dispozitë e Ligjit për AKP është aplikuar gabimisht nga ana e AL. AKP gjithashtu pohon se ankesa e ankuesit është pabazuar në kuptim të dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP respektivisht e parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit mbi punën e bashkuar – LPB. AKP nga të gjitha arsyet propozoj që ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtresave të palëve.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL me nr. PRN046-0822 të datës 14 prill 2014, me të cilën kërkohet dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, prej 2 page në NSH FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim) në shumë prej 613.18 €.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Sipas nenit 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Neni 76.7 i Ligjit të Punës nr. 03-L-212 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: *Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle:*

- 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore;
- 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore;
- 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore;
- 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetënëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore;
- 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore;

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti”. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se a ka qenë ankuesi punëtor i NSH në momentin e privatizimit të saj. Ankuesi pretendon se ka qenë punëtor i NSH-së, deri sa ndërmarrja ka shkuar në privatizim me datë 02 shtator 2013.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në Njoftimin e datë 24 mars 2006 për hyrjen e NSH-së në likuidim, listën e pagave të punëtorëve, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante, njoftimin e datës 24 mars 2006, listën e punëtorëve si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të dy pagave mujore në lartësi prej 613.18 € në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 76.7.7.4 të

Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe pagën të cilën e ka llogaritur vetë ankuesi në kërkesën e tij në procedurë të likuidimit tek AL si dhe me rastin e parashtrimit të ankesës së tij në gjykatë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Gjykata vlerëson se e paditura nuk ka mundur të dëshmojë faktin se ankuesi nuk e ka pasur statusin e punëtorit të NSH dhe faktin se me cilën bazë ligjore e ka bërë ndarjen e punëtorëve aktiv dhe pasiv, pasi që asnjë dispozitë ligjore e zbatueshme në Republikën e Kosovës nuk e parasheh këtë ndarje. Ligji i Punës i cili është në fuqi nga viti 2010, parasheh, mënyrën e themelimit të marrëdhënies së punës, përfundimin e një marrëdhënie të punës dhe të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve që janë në marrëdhënie pune te një punëdhënës i caktuar. Nga provat e lartcekura, përkatësisht nga njoftimi i datës 24 mars 2006 shihet që ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune me NSH deri në kohën e privatizimit të saj, ndërsa e paditura nuk ka dëshmuar se me ndonjë akt të ligjshëm ia kishte ndërprerë ankuesit marrëdhënien e punës para kohës së privatizimit. Po ashtu gjykata vlerëson se ankuesi ka mundur që mos të pranojë pagë dhe të mos jetë në listën e pagave në muajt e fundit para privatizimit, por kjo nuk do të thotë se ai e ka humbur statusin e të punësuarit në NSH.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit (AC-I-21-0041, AC-I-21-0039, etj.).

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 61.31 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalohet 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të te lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është nën shumën 1,000.00 Euro. Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r e

Ganimete Puka